



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 857/11 prot.

Datë 28.04.2026

V E N D I M
Nr. 559/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga OE “Shendelli” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedure e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt *“Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagja “29 Nëntori”, Fier”* me fond limit **44 449 209. 27** (dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mijë e dyqind e nente pike njezet e shtate) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
- Ankimues:** OE “Shendelli” SHPK me NIPT K07924803N dhe me adresë Lagja Kastrioti, rruga Andon Profka, 2 kullat Fier.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Fier me adresë Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të

Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.10.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedura e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier” me fond limit **44 449 209. 27** (dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mijë e dyqind e nente pike njezet e shtate) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datën 31.10.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 11.12.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. O.E AURORA KONSTRUKSION SHPK 36,837,326 I skualifikuar
2. O.E AVDULI SHPK 36,188,042.00 I skualifikuar
3. O.E BOSHNJAKU. B SHPK 36,194,070.00 I skualifikuar
4. O.E CARA SHPK 35,317,328.32 I skualifikuar
5. O.E Caushi M SHPK 37,935,484.00 I skualifikuar
6. O.E DESARET COMPANY SHPK 40,384,064.99 I skualifikuar
7. B.O.E “J O G I SHPK & “S P E K T R I” SHPK 35,329,404.00 I skualifikuar
8. O.E MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE SHPK 36,545,753.05 I skualifikuar
9. O.E NIKA SHPK 28,137,287.50 I skualifikuar
10. O.E RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN Shoqëri Aksionare 38,493,040.54 I skualifikuar
11. O.E RSM Company SH.P.K 32,694,967.00 I skualifikuar
12. O.E “SARDO” SHPK 36,314,545.00 I skualifikuar
- 13. O.E Shendelli SHPK 37,170,534.00 I skualifikuar**
14. O.E MODESTE SHPK 30,441,134.43 I skualifikuar
15. O.E 2 N SHPK 35,000,000.00 I skualifikuar
16. B.O.E C O L O M B O SHPK & NGRACAN 1934 SHPK 42,290,832.00 I skualifikuar

II.4. Në datën 09.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Anulimi”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 02, datë 12.01.2026.

II.5. Në datën 12.01.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 78/2026 protokollit, datë 12.01.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6247 e OE “Shendelli” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në datë 12.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.252/2026, ku vendosi:

1. *Të pranojë ankesën e OE ankimues “Shëndelli” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedure e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja “29 Nëntori”, Fier” me fond limit **44 449 209. 27** (dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mijë e*

dyqind e nente pike njezet e shtate) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE ankimues “COLOMBO SHPK” & “NGRACAN 1934 SHPK”, për procedurën e “Procedure e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier” me fond limit **44 449 209. 27** (dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mije e dyqind e nente pike njezet e shtate) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të BOE ankimues “COLOMBO SHPK” & “NGRACAN 1934 SHPK” dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
4. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorin ekonomik ankimues “Shëndelli” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “COLOMBO SHPK” & “NGRACAN 1934 SHPK”.
7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Shëndelli” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.7. Në datë 20.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.290/2026, ku vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedure e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier” me fond limit 44 449 209. 27 (dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mije e dyqind e nente pike njezet e shtate) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.8. Referuar sistemit të prokurimit elektronik autoriteti kontraktor në rubrikën “Kërkesa” me datë 24.02.2026 i ka kërkuar operatorit ekonomik “Shëndelli” shpk në cilësinë e operatorit ekonomik të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit pranë autoritetit kontraktor sipas parashikimeve të nenit 26 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për prokurimin publik i ndryshuar”.

II.9. Në datën 12.03.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e **Ri-vlerësimit** të

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. O.E AURORA KONSTRUKSION SHPK 36,837,326 I skualifikuar
2. O.E AVDULI SHPK 36,188,042.00 I skualifikuar
3. O.E BOSHNJAKU. B SHPK 36,194,070.00 I skualifikuar
4. O.E CARA SHPK 35,317,328.32 I skualifikuar
5. O.E Caushi M SHPK 37,935,484.00 I skualifikuar
6. O.E DESARET COMPANY SHPK 40,384,064.99 I skualifikuar
7. B.O.E “J O G I SHPK & “S P E K T R I” SHPK 35,329,404.00 I skualifikuar
8. O.E MARTINI KONSTRUKSION & REAL ESTATE SHPK 36,545,753.05 I skualifikuar
9. O.E NIKA SHPK 28,137,287.50 I skualifikuar
10. O.E RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN Shoqëri Aksionare 38,493,040.54 I skualifikuar
11. O.E RSM Company SH.P.K 32,694,967.00 I skualifikuar
12. O.E “SARDO” SHPK 36,314,545.00 I skualifikuar
- 13. O.E Shendelli SHPK 37,170,534.00 I skualifikuar**
14. O.E MODESTE SHPK 30,441,134.43 I skualifikuar
15. O.E 2 N SHPK 35,000,000.00 I skualifikuar
16. B.O.E C O L O M B O SHPK & NGRACAN 1934 SHPK 42,290,832.00 I skualifikuar

II.9.1. OE “Shendelli” sh.p.k është njohur me arsyet e **Ri-skualifikimit** të ofertës së paraqitur prej tij, me argumentet si më poshtë vijon:

“Në përfundim të verifikimit/shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar me shkresë nr.18prot, datë 26.02.2026 , protokolluar në bashki me nr.2646 prot, datë 26.02.2026, nga operatori ekonomik Shendelli SHPK, me NUIS K07924803N i kualifikuar, KVO konstaton se: Në lidhje me kriterin 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.2 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar për keto punime pika “d” sipas të cilës : d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në specialistë të çertifikuar sipas profesioneve, të paktën si më poshtë: Automakinist 1 (një); (në listëpagesë ose me kontratë pune) Bojaxhi 2 (dy); (në listëpagesë ose me kontratë pune) Suvatues 2 (dy); (në listëpagesë ose me kontratë pune) Pllakashtrues 2 (dy); (në listëpagesë ose me kontratë pune) Specialist durale 2 (dy); (në listëpagesë ose me kontratë pune) Hidraulik 2 (dy); (në listëpagesë ose me kontratë pune) Elektracist 2 (dy); (në listëpagesë ose me kontratë pune) Shofer me leje drejtimi c 2 (dy); (në listëpagesë ose me kontratë pune) Specialist IT 1 (një) (në listëpagesë ose me kontratë pune Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten , dëshmitë / çertifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve. Shënim: Për pikat a), b), c), dhe d) me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe

nisjes së afateve të ankimit duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në shkronjat a), b), c), dhe d) të pikës 2.3.2, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. • Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten dëshmitë / certifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve. • Per punonjesit per te cilet kerkohet liste pagesa duhen te jene te perfshire ne liste pagesen e muajit Shtator 2025

Për plotësimin e kriterit pika 2.3.2 pika “d” nga OE janë depozituar kontratat e punës bashkëlidhur të cilave Diplomë/Certifikatë respektive. Për punonjësën Y.R si punonjës duro-alumini janë depozituar kontratë pune, datë 20.04.2022, bashkëlidhur dhe Certifikatë lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NIUS L21410066G, me Licence LN -5883-11-2012. Për punonjësën B.S si punonjës duro-alumini janë depozituar kontratë pune, datë 01.02.2025, bashkëlidhur dhe Certifikatë lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NIUS L21410066G, me Licence LN -5883-11-2012. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare ëë.qkb.gov.al, në seksionin “Kërko për Licencë”, shoqëria “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NIUS L21410066G është licensuar me licensën me nr. LN-5883-11-2012 me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, dhe nga QKB: - Me vendimin nr. 2471 prot., datë: 20. 11. 2012, i është miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. - Me proces-verbalin nr. 11467, datë: 22. 12. 2016, i është miratuar në heshtje kërkesa për shtimin e profesioneve, si dhe shkresa nga Ministri i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.1656/2 Prot, datë 24.06.2016, me lëndë: “Miratim kerkese për licensim të Subjektit”, por në asnjërën nga këto akte nuk përfshihet kursi i formimit profesional specialist durale(specialist duro-alumini) . Përsa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se nuk plotëson pikën “d” të kriterit 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, ku kërkohet të paraqiten dëshmitë / certifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e specialistëve sipas profesionit , si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve. Në lidhje me kriterin 2.3. Kapaciteti teknik, pika 2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pika“a” sipas të cilës :: a) Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshtë dhe argumentohet ne baze te zerave te preventivit: Shënim: Për pikën 2.3.5 (a dhe b) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8. Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.5 (a dhe b), duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë: a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit. b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme),

taksat vjetore dhe certifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë ose ne nje nga format e njohura nga legjislacioni ne fuqi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes. d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij / tyre. e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. f) Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit të Mallrave (të vlefshme), lëshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për plotësimin e kriterit pika 2.3.5 pika “a” nga OE , për mjetin “Auto vetshkarkuese”, me targa AAxxxxJB, janë depozituar dokumentacioni si :Leje Qarkullimi Nr.serial:xxxx; Certifikatë e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore:Policë për sigurimin e detyrueshëm te mbajtësëve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të tretave;Taksa vjetore e mjeteve;Certifikatë “Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit” Nr.xxx, datë 28.02.2023;Foto të mjetit. Lidhur me foton e mjetit AAxxxJB e depozituar nga ana OE, rezulton se targa e mjetit është e palexueshme / e paindentifikueshme.

Përsa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se nuk përmbush shkronjën “e” të kriterit 2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion, ku kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”.

II.10. Në datën 13.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Anulimi”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 19, datë 17.03.2026.

II.11. Në datën 17.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 857/2026 protokolli, datë 17.03.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6433 e OE “Shendelli” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.12. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 857/1 prot., datë 18.03.2026.

II.13. Nëpërmjet sistemit elektronik, autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 11563/43 prot., me datë 26.03.2026, protokolluar me tonen me nr.857/2 prot., datë 26.03.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të prokurimit Publik informacion mbi procedurën e prokurimit objekt

ankimi, si dhe aktin e trajtimit të ankesës, (Vendimi i KSHA-së me nr. 11563/42 prot., me datë 25.03.2026), lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, nga ku rezulton, se KSHA e autoritetit kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.14. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 11563/43 prot., me datë 26.03.2026, protokolluar me tonen me nr.857/3 prot., datë 30.03.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të prokurimit Publik informacion mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe aktin e trajtimit të ankesës, (Vendimi i KSHA-së me nr. 11563/42 prot., me datë 25.03.2026), lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, nga ku rezulton, se KSHA e autoritetit kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.15. Me shkresën me nr. 857/4 prot., datë 01.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua organit kompetent Qendrës Kombetare Të Biznesit (QKB), duke i kërkuar informacion për subjekti privat “Agjencia Shqiptare e Punësimit”.

II.16. Me shkresën me nr. 857/5 prot., datë 01.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua të gjithë palëve në këtë proces ankimimi, se referuar nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i bën të ditur të gjitha palëve, se për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

II.17. Nëpërmjet shërbimit postar, Qendrës Kombetare Të Biznesit (QKB), me shkresën me nr. 5634/1 prot., me datë 09.04.2026, protokolluar me tonen me nr.857/6 prot., datë 14.04.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të prokurimit Publik informacion e kërkuar.

Gjithashtu, me **Vendimin Nr. 226, të datës 31.12.2025**, “Për revokimin e licencës *“Formim Profesional”*”, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Punësimit, Aftësisimit dhe Sigurimeve Shoqërore, pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, ka revokuar licencën e subjektit “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me Nr. LN-5883-11-2012.

Bulevardi “Zhan D’ark”, Prona Nr.33, Tiranë. Tel: +35542250066, qkb.gov.al

1

II.15. Me shkresën me nr. 857/7 prot., datë 22.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua Autoritetit kontraktor Bashkisë Fier, duke i kërkuar të dërgojë të plotë **kopje të njësuar me origjinalin** të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Shendelli” SHPK pranë autoritetit kontraktor, si operator ekonomik i kualifikuar i pari sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sa i takon kriterit 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.2 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, çertifikimet, i kualifikuar për keto punime pika “d” sipas të cilës : d)

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të paktën si më poshtë:

-Specialist durale 2(dy); (në listëpagesë ose me kontratë pune).

II.16. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 5133/1 prot., me datë 24.04.2026, protokolluar me tonën me nr.857/8 prot., datë 27.04.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion e kërkuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” Shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: *“Për plotësimin e kriterit pika 2.3.2 pika “d” nga OE janë depozituar kontratat e punës bashkëlidhur të cilave Diplomë/Certifikatë respektive. Për punonjësin Y.R si punonjës duro-alumini janë depozituar kontratë pune, datë 20.04.2022, bashkëlidhur dhe Çertifikatë lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NIUS L21410066G, me Licence LN -5883-11-2012. Për punonjësin B.S si punonjës duro-alumini janë depozituar kontratë pune, datë 01.02.2025, bashkëlidhur dhe Çertifikatë lëshuar nga “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NIUS L21410066G, me Licence LN -5883-11-2012. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare ëëë.qkb.gov.al, në seksionin “Kërko për Licencë”, shoqëria “Agjencia Shqiptare e Punësimit” me NIUS L21410066G është licensuar me licensën me nr. LN-5883-11- 2012 me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, dhe nga QKB: - Me vendimin nr. 2471 prot., datë: 20. 11. 2012, i është miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. - Me proces-verbalin nr. 11467, datë: 22. 12. 2016, i është miratuar në heshtje kërkesa për shtimin e profesioneve, si dhe shkresa nga Ministri i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.1656/2 Prot, datë 24.06.2016, me lëndë: “Miratim kerkese për licensim të Subjektit”, por në asnjërën nga këto akte nuk përfshihet kursi i formimit profesional specialist durale(specialist duro-alumini);, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në pikën 2.3.2. “Kapaciteti teknik”, pika “d”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.2 Stafi kryesor e mbështetës, punonjësit, certifikimet, i kualifikuar per keto punime.

d) Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të paktën si më poshtë:

- **Specialist durale** 2(dy); (në listëpagesë ose me kontratë pune)
Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten , dëshmitë / certifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.

Shënim: Për pikat **a), b), c) , dhe d)** me sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në shkronjat **a), b), c), dhe d)** të pikës 2.3.2, si më sipër kërkuar. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Për specialistët e sipërcituar sipas profesioneve, duhet të paraqiten dëshmitë / certifikatat ose çdo dokument tjetër që vërteton diplomimin apo kualifikimin e tyre sipas profesionit, si dhe kontratat individuale të punës të vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar të zbatimit të punimeve.
- Per punonjesit per te cilet kerkohet liste pagesa duhen te jene te perfshire ne liste pagesen e muajit **Shtator 2025**

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe nga dokumentacioni fizik i dorëzuar në formë shkresore pranë autoritetit kontraktor rezulton, se operatori ekonomik ofertues, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

- Formulari Përmbledhës I Vetëdeklarimit i OE“Shendelli” Shpk;

	Z. Y. Rr., me profesion Specialist durale i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Specialist durale
	Z. B. S., me profesion Specialist durale i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Specialist durale

-Kontratë pune individulae me datë 20.04.2022 lidhur midis subjektit “Shendelli” shpk dhe Z. Y. Rr., në pozicionin e specilalistit duroalumini;

-Certifikatë me nr. Amze xxx/K për Z. Y. Rr., ka përfunduar kursin profesional “punime duralumini”, lëshuar nga subjekti privat Agjencia Shqipatare e Punësimit me NIPT L21410066G dhe Nr. License LN-5883-11-2012, data e lëshimit të certifikatës 07.12.2022;

-Kontratë pune individulae me datë 01.02.2025 lidhur midis subjektit “Shendelli” shpk dhe Z. B, S., në pozicionin e specilalistit duroalumini;

-Certifikatë me nr. Amze xxxx/K për Z. B. S., ka përfunduar kursin profesional “punime duralumini”, lëshuar nga subjekti privat Agjencia Shqipatare e Punësimit me NIPT L21410066G dhe Nr. License LN-5883-11-2012, data e lëshimit të certifikatës 18.08.2025;

-Deklarata “Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimet mbi të Ardhurat nga Punësimi” për subjektin “Shendelli” shpk muaji shtator 2025;

III.1.3. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.1.4. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet;

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në original ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendas, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në original ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të

Noterisë. Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit European.”

III.1.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve

ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.1.7. Refruar arsyes së skualifikimit të OE ankimues, pretendimeve të tyre dhe materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ KPP konstaton se ky i fundit ka paraqitur në sistem Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për secilin prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, autoriteti kontraktor në kriterin e kualifikimit 2.3.2 ka përcaktuar specialistë të certifikuar sipas profesioneve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate sikurse paraqitet në pikën III.1.1 të këtij vendimi.

Kriteri i sipërpërmendur konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të renditur i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Referuar përcaktimit të bërë lidhur me specialistë të certifikuar sipas profesioneve, konstatohet se autoriteti kontraktor ka të drejtë të verifikojë disponueshmërinë e këtyre specialistëve të certifikuar sipas profesioneve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në rastin objekt gjykimi konstatohet se, autoriteti kontraktor ka kërkuar disponimin e specialistëve të certifikuar sipas profesioneve, konkretisht Specialist durale (dy copë). Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se, për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit 2.3.2, pika “d”, secili prej operatori ekonomik “Shendelli shpk” ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në pikën III.1.2 të këtij vendimi.

Konkretisht: Duke iu referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, KPP konstaton se, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, “Shendelli” shpk, në Seksionin B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”: ka deklaruar në këtë seksion, Z.Y. Rr., me profesion Specialist durale i punësuar pranë “Shendelli” shpk, në rolin

e Specialist durale dhe Z.B. S., me profesion Specialist durale i punësuar pranë “Shendelli” shpk, në rolin e Specialist durale.

Nga informacioni i dërguar nga ana e autoritetit kontraktor, konstatohet se, me shkresën përcjellëse të datës 26.02.2026, OE ankimues ka dorëzuar pranë protokollit të autoritetit kontraktor dokumentacionin fizik të kërkuar, të protokolluar me nr. 2646 prot., datë 26.02.2026, në të cilin përfshihet edhe dokumentacioni i sipërcituar në seksionin B të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit të OE “Shendelli shpk”.

Konkretisht:

-Kontratë pune individuale me datë 20.04.2022 lidhur midis subjektit “Shendelli” shpk dhe Z. Y. Rr., në pozicionin e specilalistit duroalumini;

-Certifikatë me nr. Amze xxx/K për Z. Y. Rr, ka përfunduar kursin profesional “punime duralumini”, lëshuar nga subjekti privat Agjencia Shqiptare e Punësimit me NIPT L21410066G dhe Nr. License LN-5883-11-2012, data e lëshimit të certifikatës 07.12.2022;

-Kontratë pune individuale me datë 01.02.2025 lidhur midis subjektit “Shendelli” shpk dhe Z. B. S., në pozicionin e specilalistit duroalumini;

-Certifikatë me nr. Amze xxxx/K për Z. B. S., ka përfunduar kursin profesional “punime duralumini”, lëshuar nga subjekti privat Agjencia Shqiptare e Punësimit me NIPT L21410066G dhe Nr. License LN-5883-11-2012, data e lëshimit të certifikatës 18.08.2025;

-Deklarata “Listpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimet mbi të Ardhurat nga Punësimi” për subjektin “Shendelli” shpk muaji shtator 2025;

III.1.8. Referuar sa më sipër, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka skualifikuar operatorin ekonomik Shëndelli Shpk me arsyetimin se, subjekti privat Agjencia Shqiptare e Punësimit me NIPT L21410066G dhe Nr. License LN-5883-11-2012, i cili ka lëshuar certifikatat profesionale të specilaistëve duroalumini, për të cilën figurojnë dy miratime nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, dhe nga QKB, por në asnjërin nga këto akte nuk përfshihet kursi i formimit profesional specialist durale (specialist duro-alumini), duke mos përmbushur kështu kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën 8 kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3.2 gërma “d”,. kapaciteti profesional të operatorëve ekonomikë. Marrë shkas nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, KPP me shkresën me nr. 857/4 prot., datë 01.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua organit kompetent Qendrës Kombetare Të Biznesit (QKB), duke i kërkuar informacion për subjekti privat “Agjencia Shqiptare e Punësimit”, nëse është i licencuar ky subjekt privat, për të zhvilluar kurse formimi profesionale për profilin “Specialist durale dhe nëse po, të na dërgohet dokumenti që provon se ky subjekt është i licencuar për të ofruar kurse formimi profesional për këtë profil.

Nëpërmjet shërbimit postar, Qendrës Kombetare Të Biznesit (QKB), me shkresën me nr. 5634/1 prot., me datë 09.04.2026, protokolluar me tonen me nr.857/6 prot., datë 14.04.2026, ka përcjellë pranë Komisionit të prokurimit Publik informacion e kërkuar.

Gjithashtu, me Vendimin Nr. 226, të datës 31.12.2025, "Për revokimin e licencës "Formim Profesional"", Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Punësimit, Aftësimit dhe Sigurimeve Shoqërore, pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, ka revokuar licencën e subjektit "Agjencia Shqiptare e Punësimit" me Nr. LN-5883-11-2012.

III.1.10. KPP referuar përgjigjes së dhënë nga Qendrës Kombetare Të Biznesit (QKB), si dhe dokumentacionit fizik të OE "Shendeli" shpk, Komisioni gjykon se, ankimuesi ndodhet në kushtet e plotësimit të kapacitetit teknik profesional, pika 2.3.2 gërma "d", pasi disponon në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, specialistë të certifikuar sipas profesioneve, në rastin konkret, Specialist durale (dy copë), të pajisur me Certifikatë profesionale, e cila dëshmon se, kanë përfunduar kursin profesional "punime duralumini", lëshuar nga subjekti privat Agjencia Shqiptare e Punësimit me NIPT L21410066G dhe Nr. License LN-5883-11-2012, të vlefshme në datën e zhvillimit të procedurës 31.10.2025. Referuar informacionit të dërguar nga Qendrës Kombetare Të Biznesit, sipas së cilës, subjekti privat Agjencia Shqiptare e Punësimit me NIPT L21410066G dhe Nr. License LN-5883-11-2012, i është revokuar licenca me Vendimin nr. 226, të datës 31.12.2025., ndërsa kur është zhvilluar procedura e prokurimit objekt ankimi me datë 31.10.2025, kjo licencë ka qenë aktive dhe e vlefshme në datën e hapjes së procedurës së prokurimit.

Në këtë kuptim KPP gjykon se, ankimuesi ndodhet në kushtet e përmbushjes së kriterit të vecantë të kualifikimit, duke dëshmuar se disponon dokumentacionin e nevojshëm për Specialist durale (dy copë), të pajisur me Certifikatë profesionale, e cila dëshmon se, kanë përfunduar kursin profesional "punime duralumini", lëshuar nga subjekti privat Agjencia Shqiptare e Punësimit me NIPT L21410066G dhe Nr. License LN-5883-11-2012, të vlefshme në datën e zhvillimit të procedurës 31.10.2025.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e OE "Shendelli" shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: ".....Për plotësimin e kriterit pika 2.3.5 pika "a" nga OE , për mjetin "Auto vetshkarkuese", me targa AAXXJB, janë depozituar dokumentacioni si :Leje Qarkullimi Nr.serial:xxx; Certifikatë e Kontrollit Teknik të Mjeteve Rrugore:Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësëve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të tretave;Taksa vjetore e mjeteve;Certifikatë "Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit" Nr.xxx, datë 28.02.2023;Foto të mjetit. Lidhur me foton e mjetit AAXXJB e depozituar nga ana OE, rezulton se targa e mjetit është e palexueshme / e paindentifikueshme.....", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2.3.5. "Kapaciteti teknik", të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion:

a) *Mjetet, makineritë dhe pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshtë dhe argumentohet ne baze te zerave te preventivit:*

Lista e makinerive për objektin :Rikonstrukcion i objektit 3K(Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier					
NR.	EMERTIMI I MAKINERISË	NR I MAKINERIVE	MANOVRATOR /SHOFER	SHËNIME	Statusi
1	Elektroorgano	1	-	Preventivi punime ndertimore ne anazlizen me nr. 2.358/b	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
2	Pompë suvatimi	1	-	Preventivi punime ndertimore ne analizen me nr 2.310	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
3	Autovinç me peshë ngritëse min. 5 ton	1	Automakinist	Preventivi punime ndertimore ne analizen me nr. 2.262/5, 2.262/1, 2.71/2, 2.86., 2.204, 2.166, 2.166/1a, 2.273/a, 2.267/a, 2.273, 2.218, 2.300, 2.310, 2.331.Preventivi elektrik ne analizen me nr. 4.51; preventivi hidroeknik ne analizen me nr. 2.488	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
4	Auto vetshkarkuese	2	Shofer me leje drejtimi C	Preventivi punime ndertimore ne analizen me nr. 2.426, 2.426/3, 2.426/4, 2.395/a, 2.386/2, 2.388/1, 2.375/1, 2.281/5, 2.262/5,2.262/1, 2.71/2, 2.86., 2.201, 2.204, 2.166, 2.166/1a, 2.273/a, 2.267/a, 2.291, 2.288, 2.273, 2.701, 2.195, 2.209, 2.212, 2.218, 2.310, 2.324a, 2.326, 2.331, 2.358/b, 2.412, 2.414, 2.421, 2.431, 2.37/5a, 2.431/a, 2.510, 2.492, 3.929/4, 4.51, disa analiza ne preventivin hidroteknik dhe mnz	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
5	Skelë metalike	1000 m2	-	Kjo sasi skele eshte e nevojshme	Në pronësi ose

				per kryerjen e punimeve ne afatin 9 mujor e specifikuar ne grafikun e punimeve. Kjo sasi mbulon nevojat per skele per preventivat e tjera me alternime.	me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
6	Tokmak elektrik	1	-	Preventivi elektrik ne analizen me nr 2.36	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
7	Ekskavator 0.25 m3	1	eskavatorist	Preventivi elektrik ne analizen me nr. 3.87/a	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi
8	Vibrator	1	-	Preventivi punime ndertimore ne analizen me nr. 2.201, 2.204, 2.119/1a; preventivi hidroteknik analiza me nr 3.589	
9	Trapan elektrik	1	-	Preventivi punime ndertimore tek te punime tavani dhe suvatimi zeri me nr 2.358/b. preventivi hidroteknik analiza me nr.2.221-M, 2.217 dhe 2.215	Në pronësi ose me qera ose në një nga format e njohura nga legjislacioni në fuqi

Shënim: Përlllogaritja e makinerive është bërë bazuar në - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve", sipas portalit SIM në e-albania. Emërtimi i manovratorve është bazuar në nenin 8 të Urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 "Për miratimin e rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teorike- praktike të kandidateve, si dhe dhenien e deshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe tokë , si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit"Është menduar për shkak të mos llogaritjes në projekt vendi i instalimit dhe kostua e vinçit kullë ,në vend të vinç kulle 4-6 ton si dhe autovinç 5 ton të kërkohet autovinç me peshë ngritëse min 5 ton.

b) *Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion pajisjet teknike (pronësi ose me qera ose sipas legjislacionit në fuqi), të nevojshme për ekzekutimin e kontratës si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8):*

- *Kokore, minimumi 45 copë.*
- *Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila, minimumi 2 copë.*
- *Komplet i ndihmës së shpejtë, minimumi 2 copë.*
- *Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi, 4 copë.*

Shënim: Për pikën 2.3.5 (a dhe b) si më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin deklaratën sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.5 (a dhe b), duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin si më poshtë:

a) Për mjetet me goma që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikata e pronësisë së mjetit.

b) Për mjetet e siguruara me qera, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (të vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikata e pronësisë së mjetit, si dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerasë ose ne nje nga format e njohura nga legjislacioni ne fuqi, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

c) Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

d) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij / tyre.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

f) Makinat e transportit të shoqërohen gjithashtu edhe me Leje te Transportit të Mallrave (të vlefshme), lëshuar nga organet kompetente në emër të shoqërisë apo subjektit pronar të mjetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e tërësisë së informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ofertues për këtë procedurë prokurimi, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" te ndryshuar.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. (pika 6 e nenit 26 të V.K.M. nr.285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar).

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe nga dokumentacioni fizik i dorëzuar në formë shkresore pranë autoritetit kontraktor rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë ofertues, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “Shendelli” shpk;
Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, në pikën C “Deklaratë” në seksionin “Për Disponimin E Mjeteve/Pajisje/Makinerive Të Nevojshme Për Realizimin E Punimeve Objekt Kontrate”, kjo pjesë është ngarkuar në sistem si më poshtë vijon:

C: DEKLARATË

“PËR DISPONIMIN E MJETEVE/PAJISJE/MAKINERIVE TË NEVOJSHME

PËR REALIZIMIN E PUNIMEVE OBJEKT KONTRATE”

Në cilësinë e operatorit ekonomik Shendelli Sh.p.k , deklaroj nën përgjegjësinë time se, kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
Auto vetshkarkuese	AAxxxx	FRD0xxxxxxx	WDxxxxxxx	PRONESI

-Leje qarkullimi për mjetin me targa AAxxxxJB, Nr. Lejes qarkullimit FRD0xxxxxxx, Nr. Shasisë xxxxx, në pronësi, certifikatë e kontraollit teknik të mjetit AAxxxxJB e vlefshme deri me datë 14.10.2026; Policë e sigurimit për mjetin AAxxxxJB e vlefshme 10.04.2026; taksa vjeotre e mjetit AAxxxxJB, certifikatë nr.xxx, datë 28.02.2023 për trasnport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, e vlefshme deri me datë 27.02.2028; foto e mjetit.

III.2.3. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e

duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.4. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet;

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht

në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendas, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit Europian.”

III.2.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese

brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e

gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma "dh", se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.7. Refruar arsyes së skualifikimit të OE ankimues, pretendimeve të tij dhe materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ KPP konstaton se ky i fundit ka paraqitur në sistem Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit për operatorin ekonomik, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, autoriteti kontraktor në kriterin e kualifikimit 2.3.5 ka përcaktuar mjetet dhe pajisjet e nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate sikurse paraqitet në pikën III.2.1 të këtij vendimi.

Kriteri i sipërpërmendur konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të renditur i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Referuar përcaktimit të bërë lidhur me pajisjet dhe mjetet, konstatohet se autoriteti kontraktor ka të drejtë të verifikojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vleresimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se, për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit 2.3.5, operatori ekonomik ankimues “Shendelli” shpk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar.

Lidhur me arsyen e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor për operatorin ekonomik ankimues, *Lidhur me foton e mjetit AAxxxJB e depozituar nga ana OE, rezulton se targa e mjetit është e palexueshme / e paidentifikueshme*, nga verifikimi i këtij dokumentacioni, (përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me shkresën me nr. 5133/1 prot., me datë 24.04.2026, protokolluar me tonen me nr.857/8 prot., datë 27.04.2026) KPP konstaton se: për mjetin AAxxxJB, ankimuesi ka dorëzuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar nga autoriteti kontraktor, përfshi këtu foto edhe dokumnetacion teknik të vlefshëm, dokumentacion i cili përputhet me deklaratimet e bëra nga ankimuesi në formularin e vetdeklarimit, duke përmbushur kështu kriterin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Për foton e mjetit të pretenduar me targë AAxxxJB, në të cilin nuk evidentohet qartësisht targa e mjetit, KPP gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar, ankimuesi ka dhënë një indicie që plotëson kriterin 2.3.5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, sa i takon fotos së mjetit me targë AAxxxJB. Neni 82 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar përcakton se “*...Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë vetëm me shkrim ose të pasqyruara në procesverbal...*”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet ti kërkojë sqarime operatorit ekonomik ankimues lidhur me foton e mjetit AAxxxJB e depozituar nga ana OE, e cila rezulton se targa e mjetit është e palexueshme / e paidentifikueshme, dhe pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni të rivlerësojë ofertën e ankimuesit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik*”

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e OE ankimues “Shëndelli SHPK”, për procedurën e “Procedure e hapur me mjete elektronike”, me Nr. REF-65194-10-15-2025, me objekt “Rikonstruksion i objektit 3K (Çerdhe+kopesht), Lagjja "29 Nëntori", Fier” me fond limit **44 449 209. 27** (dyzet e katër milion e katërqind e dyzet e nente mijë e dyqind e nente pike njezet e shtate) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 31.10.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “Shëndelli” SHPK, sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Shëndelli” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

